

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të pavarur
31 Dhjetor 2022**

Përmbajtja:

<u>Raport i auditorëve të Pavarur..</u>	3
Bilanci i Gjendjes.....	5
Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.....	6
Pasqyra e Rrjedhës se Parasë.....	7
Pasqyra e Ndryshimeve ne Fonde.....	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-15

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar: Këshillit Drejtues të Odës së mjekëve te Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Opinion i pa kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te bashkëngjitura të **Odës së mjekëve te Kosovës** (në vijim referuar si “Organizata” apo “OMK”) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2022, pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën individuale të ndryshimeve në fonde për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues te përfshira ne fq. 5-15.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës më 31 dhjetor 2022, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në pajtim me Parimet e Përgjithshme te Pranueshme te Kontabilitetit.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë trajtuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tone më sipër, dhe ne nuk do të japin një opinion të veçantë mbi këto çështje.

Ne kemi vendosur se nuk ka çështje të rëndësishme të auditimit për të komunikuar në raportin tonë.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k,


Ymer Shatri

NDËRMARRJA SHËRBYESE
"AUDIT & CONTO"
sh.p.k.
PRISHTINE

Auditor Ligjor
Tel: +38344506702
28 Prill, 2023

Pasqyra e Pozitës financiare

Pasuritë	Shënimi	Me 31 Dhjetor	
		2022	2021
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	5	810,867	611,305
Llogarite e arketueshme dhe kërkesat tjera, neto		0	820
Pasuri tjera afatshkurtra			
Gjithësej pasuritë afatshkurtra		810,867	612,125
Pasuritë afatgjata			
Prona, impiantet dhe pajisjet	3	20,516	19,000
Pasuritë e paprekshme	4	1,948	160
		22,465	19,160
Gjithësej pasuritë		833,332	631,285
Detyrimet			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogarite e pagueshme dhe te tjera	5	9,510	2,876
Te hyrat e shtyra	6	128,214	19,236
Gjithësej detyrimet afatshkurtra		137,724	22,113
Detyrimet qarkulluese			
Detyrimet e shtyra tatimore			
Detyrimet tjera afatgjata			
Gjithësej detyrimet afatgjata		0	0
Gjithësejt detyrimet		137,724	22,113
Ekuiteti dhe detyrimet			
Ekuiteti			
Kapitali dhe rezervat			
Fitimet (Humbjet) e Akumuluar		609,173	491,788
Fitimi (Humbja) e vitit		86,436	117,385
Gjithësejt ekuiteti		695,608	609,173
Gjithësejt ekuiteti dhe detyrimet		833,332	631,285

Këto pasqyra financiar janë aprovuar nga Menaxhmenti i Organizatës me 29 Mars 2023 dhe autorizuar për publikim nga:

Kryesues

Pleurat Sejdiu



Financier

Pajtime Vllasa

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor		
	Shënimi	2022	2021
Të hyrat operative			
Te hyrat	8	577,383	469,897
Te hyrat nga donacionet		79,670	13,330
Te hyrat nga amortizimi i asetëve donacion		1,747	796
Fitimi / (humbja) operative		658,800	484,023
Shpenzimet operative			
Shpenzimet e pagave dhe mëditjeve	9	-256,461	-214,209
Shpenzimet e zhvlerësimit	4&5	-6,200	-4,985
Shpenzimet tjera operative	10	-309,704	-147,444
Total shpenzimet operative		-572,365	-366,638
Shpenzimet financiare			
Të ardhurat financiare			
Fitimi / (Humbja) para tatimit		86,436	117,385
Tatimi në fitim			
(Humbja)/Fitimi i vitit		86,436	117,385
Te hyrat tjera gjithëpërfshirëse neto nga tatimet			
Total te hyrat gjithëpërfshirëse për vitin		86,436	117,385

Pasqyra e rrjedhës së parasë

	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
	2,021	2,020
Aktivitetet Operative		
Fitimi (Humbja) para tatimit	86,436	117,385
<i>Përshtatur për:</i>		
Te hyrat nga grantet		
Zhvlerësimin	6,200	4,985
Ndryshimet në kapital		
Vlera neto e aseteve të Dëmtuara	33	
<i>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapital punues</i>	92,669	122,370
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>		
Tatimin në fitim		
Stoqet		
Të arkëtueshmet e tjera tregtare	820	(820)
Detyrimet e tjera dhe tregtare	115,611	21,519
	209,100	143,069
Aktivitetet Investuese		
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve	(9,538)	(7,644)
Investimet tjera		
	(9,538)	(7,644)
Aktivitetet Financuese		
Huat afatgjata		
Ndryshimet në overdraft		
Tërheqja e dividendes		
		-
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalentët e parasë	199,562	135,398
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim	611,305	475,907
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund	810,867	611,305

Pasqyra e ndryshimeve ne fonde

	Kapitali aksionar dhe rezervat	Humbjet e mbajtura	TOTALI
	----- (në Euro) -----		
Gjendja me 1 Janar, 2021			
Transaksionet me pronarin		491,788	491,788
Fitimi i vitit			0
Te hyra gjithëpërfshirëse tjera		117,385	117,385
Deponimet e kapitalit shtesë			0
Dividentat			0
ndryshimet ne kapital			0
Korrigjimet për gabime te viteve te mëhershme			0
Total te hyra gjithëpërfshirëse			0
Gjendja me 31 Dhjetor, 2021	0	609,173	609,173
Gjendja me 1 Janar, 2022	0		
Transaksionet me pronarin		609,173	609,173
Fitimi i vitit			
Te hyra gjithëpërfshirëse tjera		86,436	86,436
Deponimet e kapitalit shtesë			
Dividentat			
Korrigjimet per gabime te viteve te mëhershme			
Rezervat rivolarizuese			
Total te hyra gjithëpërfshirëse			
Gjendja me 31 Dhjetor, 2022	0	695,609	695,609

1. Informata te përgjithshme

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtrojnë veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

Fillet e para për themelimin e Odës së Mjekëve janë shënuar nga viti 2010. E gjitha ka filluar si iniciativë e Odës së Mjekëve të Gjermanisë, pasi është vërejtur mungesa e përfaqësimit profesional të mjekëve në evente ndërkombëtare të karakterit shëndetsor. Inagurimi i Odës së Mjekëve të Kosovës është bërë me datën 10 nëntor 2013, dhe gjithashtu zgjedhja e kryetares së OMK-s, Prof. Dr. Zylfije Hundozi. Kryetarja pas zgjedhjes së saj propozoj si zëvendës kryetarë të OMK-së, dr. Arben Grazhdani dhe dr. Rrezart Halili ku të dy propozime u votuan nga antarët e kuvendit. Në mes tjerash, në këtë ceremoni solemne kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Odave Mjekësore nga Gjermania, Austria, Hungaria, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Shqiperia dhe përfaqësues të lartë të misioneve diplomatike në Kosovë. Si mysafirë special kanë qenë të pranishëm edhe presidenti i Asociacionit Mjekësor Botëror, dr. Otman Kloibe dhe zëvendës presidenti i Shoqatës Gjermane Mjekësore dhe njëherish Kryetari i Odës së Mjekëve të Bavarisë, dr. Maks Kaplan.

2. Bazat e përgatitjes dhe politikat e rëndësishme të kontabilitetit

2.1 Politikat e rëndësishme të kontabilitetit

a) Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Parimet e Përgjithshme të Pranueshme të Kontabilitetit.

b) Bazat e përgatitjes dhe prezantimit

Pasqyrat financiare janë të prezantuara në Euro. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme, dhe përveç nëse ceket ndryshe, ato janë të njëjtat me politikat aplikuar në vitin paraprak.

Periudha raportuese e organizatës është 12 muaj duke mbaruar me 31 Dhjetor të secilit vit. Pasqyrat Financiare janë përgatitur në baza krahasuese duke reflektuar bilancet e këtij vitit dhe të atij paraprak.

c) Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

d) Prona, impiantet dhe pajimet

Zërat e përfshirë në këtë kategori përfaqësojnë vetura, pajisjet e zyrës dhe pajisjet e teknologjisë informative dhe njihen si asete vetëm kur është e mundur që:

- benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me asetin do të rrjedhin në Organizatë dhe
- kosto e asetit mundet të matet me besueshmëri.

Asetet fillimisht regjistrohen sipas koston. Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribueshme në përvetësimin e zëri.

Organizata e mban asetet në kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar apo humbjet e akumuluar të demit, nëse ka. Zhvlerësimi i aseteve regjistrohet në baza vjetore duke përdorur metodën lineare dhe duke pas parasysh jetëgjatësinë e aseteve. Normat e aplikuar të zhvlerësimit janë:

- Veturat - 20 %
- Pajisjet tjera – 20 %

e) Grantet

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe

- grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

f) Llogarite e pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë njohur kur shuma është e përcaktueshme dhe obligimi për të shlyer shumën ekziston si rezultat i operacioneve të Organizatës. Ato janë paraqitur në kosto.

a) Shpenzimet

Shpenzimet njihen ne momentin kur ndodhin.

b) Valutat e huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

Ne funde te vitit, bilancet e mbetura ne valuta te huaja janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit ne ditën e fundit te periudhës raportuese. Fitimet apo humbjet nga këto këmbime janë njohur ne pasqyrën e te ardhurave.

c) Tatimi ne fitim

Organizata është e liruar nga tatimi ne fitim.

d) Te hyrat & shpenzimet

Gjate kësaj periudhe, Organizata ka pranuar grante për te financuar aktivitet dhe operacionet e projekteve. Grantet janë pranuar për projekte specifike te dorëzuara tek donatorët dhe te aprovuara prej tyre.

Oda e mjekëve të Kosovës
 Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor, 2022

3. Prona dhe pajisjet

	Pajisje TI	Mobile për zyre	Inventar për zyre	Total
Me 01 Janar 2022				
Kosto	26,752	5,577	5,644	37,973
Shtesat gjate vitit	798	6,740	100	7,638
Shlyerja e asetëve			-208	-208
Transferet e brendshme				
Me 31 Dhjetor 2022	27,550	12,317	5,536	45,403
Zhvlerësimi I Akumuluar				
Me 1 Janar 2022	-13,507	-3,370	-2,096	-18,973
Zhvlerësimi i vitit	-3,665	-1,343	-1,080	-6,089
Shlyerja e asetëve				0
Largimi i Asetëve			175	175
Me 31 Dhjetor 2022	-17,172	-4,713	-3,000	-24,886
Vlera neto ne libra 01 Dhjetor 2022	26,752	2,207	3,548	19,000
Vlera neto ne libra 31 Dhjetor 2022	10,378	7,603	2,535	20,516
	Pajisje TI	Mobile per zyre	Inventar per zyre	Total
Me 01 Janar 2021				
Kosto	20,543	4,978	4,808	30,328
Shtesat gjate vitit	6,209	599	836	7,644
Shlyerja e asetëve				0
Transferet e brendshme				
Me 31 Dhjetor 2021	26,752	5,577	5,644	37,973
Zhvlerësimi I Akumuluar				
Me 1 Janar 2021	-10,508	-2,511	-1,076	-14,094
Zhvlerësimi i vitit	-3,000	-859	-1,020	-4,879
Shlyerja e asetëve				0
Largimi i Asetëve				
Me 31 Dhjetor 2021	-13,507	-3,370	-2,096	-18,973
Vlera neto ne libra 01 Dhjetor 2021	20,543	2,467	3,732	16,234
Vlera neto ne libra 31 Dhjetor 2021	13,245	2,207	3,548	19,000

Oda e mjekëve të Kosovës
 Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor, 2022

4. Pasurit e patrupëzuara

	Softueri	Total
Me 01 Janar 2021		
Kosto	400	400
Shtesat gjate vitit	1,900	1,900
Shlyerja e asetëve		
Transferet e brendshme		
Me 31 Dhjetor 2021	2,300	2,300
Zhvlerësimi I Akumuluar		
Me 1 Janar 2022	-240	-240
Zhvlerësimi i vitit	-112	-112
Shlyerja e asetëve		
Largimi i Asetëve		
Me 31 Dhjetor 2022	-352	-352
Vlera neto ne libra 01 Dhjetor 2022	160	160
Vlera neto ne libra 31 Dhjetor 2022	1,948	1,948
	Softveri	Total
Me 01 Janar 2021		
Kosto	400	400
Shtesat gjate vitit		
Shlyerja e asetëve		
Transferet e brendshme		
Me 31 Dhjetor 2021	400	400
Zhvlerësimi I Akumuluar		
Me 1 Janar 2021	-160	-160
Zhvlerësimi i vitit	-80	-80
Shlyerja e asetëve		
Largimi i Asetëve		
Me 31 Dhjetor 2021	-240	-240
Vlera neto ne libra 01 Dhjetor 2020	240	240
Vlera neto ne libra 31 Dhjetor 2020	160	160

5. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	Me 31 Dhjetor 2022	Me 31 Dhjetor 2021
Llogaritë rrjedhëse në bankat vendore	810,867	611,305
Paraja në dorë		
	810,867	611,305

5. Llogaritë e pagueshme

	31 Dhjetor 2022 (në EUR)	31 Dhjetor 2021 (në EUR)
Llogaritë e pagueshme	9,510	2,876
Totali i llogarive të pagueshme	9,510	2,876

6. Të hyrat e shtyera

	Me 31 Dhjetor 2022	Me 31 Dhjetor 2021
Te hyrat e shtyra për asete	10,465	5,632
Te hyrat e shtyra -Obelisku	117,750	13,605
	128,214	19,236

7. Lëvizja e të hyrave të shtyera

	Me 31 Dhjetor 2022	Me 31 Dhjetor 2021
Te hyrat e shtyra për asete	19,236	218
Te marra gjate vitit-Asete	6,580	6,209
Te marra gjate vitit-Obelisku	1,000	33,575
Donacionet e marra	197,420	
Te njohura gjate vitit	-96,022	-20,766
Vlera neto e aseteve të shlyera gjate vitit	128,214	19,236

8. Të hyrat

	Per vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2022	2021
Të hyrat nga Anëtarësia	375,390	349,548
Anëtarësimet e mjekëve të huaj	10,310	13,205
Te hyrat nga licencimi dhe ri licencimi i mjekëve	98,880	48,850
Te hyra tjera	92,803	58,294
Total shitjet	577,383	469,897

9. Kosto e Stafit

	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
	2022	2021
Pagat për personelin e rregullt	136,999	116,110
Mëditjet për Kuvendin	101,366	27,615

Oda e mjekëve të Kosovës
Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor, 2022

Mëditjet për Këshille, Komisione dhe udhëtime zyrtare	143,023	60,489
Kontributet pensionale	12,072	9,996
Pagat Bruto	256,461	214,209

10. Shpenzimet tjera

	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
	2022	2021
Material shpenzues për zyrë	5,022	8,208
Reprezentacioni	2,625	2,489
Mbështetja e mjekëve për EVP	91,992	54,498
Shpenzimet e telefonit	1,264	1,057
Shpenzimet e postës	582	465
Shpenzimet e transportit	1,590	639
Hulumtime (sondazhe, anketa, fokus grupe)		6,070
Faksimil	6,858	5,709
Provizioni bankarë	2,292	1,194
Salla dhe pije për mbledhjen e Kuvendit	7,493	5,089
Kongresi I OMK	77,498	
Shpenzime tjera operacionle	21,653	17,357
Mbështetje Financiare nga Fondi për Solidaritet	13,306	24,700
Udhëtimet zyrtare jashtë RKS	23,676	
Shpenzimet e ndërtimit-OBELISKU	53,856	19,970
Total shpenzimet tjera operative	309,704	147,444